

Për:	Operatori Ekonomik: N.P.T. "Bamirs" me adresë në Suharekë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit 
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	17.06.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim**, të datës: **17.06.2021**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: N.P.T. "Bamirs" me adresë në Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **VAZHDIMI I NDËRTIMIT TË SHTËPISË MUZE "UKSHIN HOTI" NË KRUSHË E MADHE**, me Numër të prokurimit: **623-21-2033-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-21-017-5-2-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **HEDHET POSHTË** si e jashtë afatshme Kërkesa për rishqyrtim e parashtruar nga Operatori Ekonomik: N.P.T. "Bamirs" me adresë në Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **VAZHDIMI I NDËRTIMIT TË SHTËPISË MUZE "UKSHIN HOTI" NË KRUSHË E MADHE**, me Numër të prokurimit: **623-21-2033-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-21-017-5-2-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ - Komuna e Rahovecit, pasi që e njëjta është parashtruar në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 5 dhe nenit 108/A të LPP-së, si dhe nenin 4 pika (b) të Rregullat për paraqitjen të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave.
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj Vendimin e miratuar nga Autoriteti Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **VAZHDIMI I NDËRTIMIT TË SHTËPISË MUZE "UKSHIN HOTI" NË KRUSHË E MADHE**, me Numër të prokurimit: **623-21-2033-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-21-017-5-2-1**, dhe mbështetë Vendimin e miratuar nga Autoriteti Kontraktues.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

ARSYETIM

Operatori Ekonomik ankues: N.P.T. “Bamirs” me adresë në Suharekë, si palë e pakënaqur ka deponuar Kërkesë për Rishqyrtim pran AK Komuna e Rahovecit, me datë: 17.06.2021 në Ora: 00:35 h, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **VAZHDIMI I NDËRTIMIT TË SHTËPISË MUZE “UKSHIN HOTI” NË KRUSHË E MADHE**, me Numër të prokurimit: 623-21-2033-5-2-1, Numër i brendshëm: 623-21-017-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ - Komuna e Rahovecit.

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

Operatori Ekonomik ankues: N.P.T. “Bamirs” me adresë në Suharekë, ka bërë kërkesë për rishqyrtim përmes e-prokurimit me datë: 17.06.2021 në Ora: 00:35 h, e që i bije ditë e tetë (8), ndërsa afati i fundit për kërkesë për rishqyrtim lidhur me këtë aktivitet të prokurimit ka qenë data: 15.06.2021, ora: 16:00 h.

Pra nga sqarimet e dhëna si me lart mund të konkludojm se OE ankues, Kërkesën për Rishqyrtim e ka paraqitur ne kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 5 të LPP-së në të cilën thuhet: *Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit. Autoriteti kontraktues mund të vendosë që të caktojë një kohë tjetër me kusht që ai është jo më herët se në ora 12:00 të ditës së skadimit*, andaj i njëjti ka ushtruar mjetin juridik ne AK jashtë afatit ligjore të paraparë me Ligjin e Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës dhe akteve nen ligjore për prokurim publik.

Prandaj duke u nisur nga sqarimet e dhëna si me lart AK Komuna e Rahovecit, konstaton se ankesa e OE-së: N.P.T. “Bamirs” me adresë në Suharekë, e parashtuar me datën: 17.06.2021 në Ora: 00:35 h, është e jashtë afatshme për faktin se nuk ka vepruar konform nenit 4 të rregullat për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrimin të ankesave pran OSHP-së dhe vlera e tarifave të ankesave, konkretisht nuk është respektuar “Periudha kohore për dorëzimin e një kërkesë për rishqyrtim pran Autoritetit Kontraktues”, ku në nenin 4.1 pika b. thuhet: Kërkesa për shqyrtim duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme: *Kurdo qe kërkesa për rishqyrtim ka te beje me vendimin për dhënie të një kontratë ose te një konkursi te projektimit brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit te projektimit që i është dërguar ankuesit.*

Gjithashtu ka edhe interpretim nga OSHP lidhur me rast te ngjashëm për refuzim te një kërkesë te tille si ne vijim, i cili mund te merret parasysht:

<http://arkivaoshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2019/801-19vend.pdf>

Prandaj Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit vjen në përfundim se Operatori Ekonomik ankues: N.P.T. “Bamirs” me adresë në Suharekë, e ka lëshuar afatin ligjore për parashtrim të kërkesës për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Me respekt:
Zyra e Prokurimit
Komuna e Rahovecit

Data: 17.06.2021